



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 30 tetor 2018, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Avdullah Hoti, Valon Ramadani, Andin Hoti, Etem Arifi, Emilija Rexhepi dhe Ali Lajçi.

Munguan: Mërgim Lushtaku, Verica Qeraniq, Albert Kinolli dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Antigona Ibraj, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

I ftuar: Skënder Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pjesëmarrësit tjerë: Driton Ademi, Izedin Bytyçi nga MPMS; Astrit Bllaca, Emine Fazliu nga ZKA.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 24.10.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.10.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.10.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Driton Selmanaj, theksoi se deputet raportues për prezantimin e të gjeturave nga raporti i auditimit për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është deputeti Ali Lajçi dhe e ftoi të prezantojë të gjeturat e këtij auditimi.

Ali Lajçi, prezantoi në pika shkurtra të gjeturat në raportin e auditimit për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai tha se për këtë vit, Zyra Kombëtare e Auditimit për këtë ministri ka dhënë opinion të pamodifikuar, me theksim të çështjes. Pasqyrat financiare vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale. Ai tha se ekzistojnë disa probleme apo të meta, siç janë ato me personelin, me prokurimin, me planifikim të buxhetit, shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, subvencioneve dhe të pagave. Të gjitha këto fusha janë përcjellë me dobësi. Ai, gjithashtu, përmendi çështjen e rekomandimeve të viteve paraprake, të cilat kishin mbetur të pazbatuara.

Skënder Reçica, tha se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka lidhur marrëveshje të bashkëpunimit me Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Bashkësinë Islame të Kosovës, me qëllim që të regjistrohen personat të cilët më nuk janë në jetë dhe që të ndalohet praktika e përfitimit të familjarëve për shkak të mosregjistrimit me kohë. Ai tha se për të ndaluar këtë dukuri, në tërësi, përveç kontrollit çdo 6 muaj, ministria për momentin nuk ka ndonjë mekanizëm tjetër. Ai përmendi edhe pensionet e dyfishta, ku tha se gjatë vitit të kaluar është instaluar një softuer, mirëpo që ende nuk ka një softuer të integruar për të gjitha sferat. Po ashtu, tha se personave që ishin në kontratë mbi vepër nuk iu është vazhduar kontrata. Lidhur me pagesat e parregulltat, tha se personat që kanë punuar në zgjedhje janë cilësuar si persona të punësuar, edhe pse ata kanë punuar vetëm disa ditë.

Driton Selmanaj, tha se është shqetësuese rritja e pagesave të parregullta. Ministria ka bërë pagesa në bazë të kërkesës e jo në bazë të kontratës për furnizim me barna. Ai përmendi se 25 persona janë pranuar, duke mos përfillur procedurat e rekrutimit. Ai, gjithashtu, tha se në dy raste, ministria ka përzgjedhur operatorët ekonomikë të papërgjegjshëm.

Emilija Rexhepi, tha se sa i përket numrit të angazhuar të punësuarve në kontratë mbi vepër, është shumë i madh. Nga këta asnjë nuk është nga komuniteti boshnjak. Në qendrën rajonale në Prizren, është një numër i konsideruar i pensionistëve, të cilët për çfarëdo pyje nuk mund të komunikojnë në gjuhën amtare. Gjatë mandatit të ministrit të kaluar ka qenë një i punësuar, megjithatë nuk iu ka vazhduar kontrata e punës. Siç shihet, në raportin e auditimit, 25 të punësuar kanë qenë të angazhuar si të punësuar me kontratë mbi vepër dhe asnjë nga ta nuk ka qenë nga komuniteti boshnjak.

Andin Hoti, pyeti rreth dallimeve në mes përfituesit më shumë se një skemë pensionale dhe përfituesit që përfitojnë nga më shumë se një kategori. Ai tha se është shumë e padrejtë që një person që arrin pensionin e moshës, të mos e gëzojë edhe pensionin e veteranit, nëse ka qenë veteran. Lidhur me këtë, pyeti ministrin: A është ndërmarrë diçka që të ndryshohet kjo gjendje?

Avdullah Hoti, pyeti: Përse nuk po zbatohet Ligji për veteranët e luftës? Ai tha se ky ligj parasheh që të bëhet kategorizimi i veteranëve të luftës dhe maksimumi i shpenzimit për këtë kategori nuk duhet të kalojë 0.7% të bruto produktit vendor.

Skënder Reçica, tha se ne kemi hartuar një rregullore dhe ajo në fund të nëntorit të vitit 2017 ka kaluar në Qeveri.

Përfundim

KMF vendosi që raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të mos adresohet për në seancë plenare. Rekomandimet nga ky raport do të diskutohen në takimin e radhës së komisionit dhe do t'i dorëzohen MPMS.

4. Të ndryshme

Driton Selmanaj, njoftoi deputetët që në mbledhjen e kaluar kanë diskutuar lidhur me mundësinë që komisioni t'i kërkojë Zyrës Kombëtare të Auditimit, që në auditimin e vitit të ardhshëm, t'i trajtojë ndarjet e granteve dhe subvencioneve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Ai tha se Ministrinë e Bujqësisë, ZKA-ja tashmë është duke e trajtuar nga auditori i jashtëm. Ai pyeti deputetët, nëse janë të pajtimit që t'iu kërkojnë raport edhe ministrive sesi e kanë shpenzuar buxhetin në këtë kategori.

Avdullah Hoti, tha se kërkesa nga mbledhja e kaluar ka qenë që komisioni të kërkojë raport me shkrim dhe në bazë të raportit që hartojnë këto ministri, ne t'i thërrasim ministrat në raportim ose një grup i deputetëve nga ky komision t'i vizitojë këto ministri. Kërkesa që kjo të bëhet pjesë e auditimit, është kërkesë për një raport që do të vijë në qershor të vitit të ardhëm, sepse gjendja tashmë është shumë alarmante. Ai tha se një zëvendësministër është shkarkuar, për shkak se ka hyrë në pazare për subvencione në bujqësi. Më tej, theksoi se KMFP duhet të jetë në funksion të mbikëqyrjes ndaj ministrive, kurse auditori mund ta kryejë punën e vet.

Përfundim

KMFP vendosi që të kërkojë raport të detajuar, lidhur me buxhetin dhe shpenzimet e parasë publike për grante dhe subvencione për periudhën kohore tetor 2017 - tetor 2018, nga Ministria për Zhvillim Rajonal, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, ndërsa Zyrës Kombëtare të Auditimit t'i rekomandojë që në planin vjetor të auditimit, për sezonin e ri të auditimit,

të auditojë ndarjet dhe shpenzimet e granteve dhe subvencioneve, për institucionet e lartcekura.

Driton Selmanaj, njoftoi deputetët që sekretari nuk ka kthyer përgjigje, lidhur me kërkesën për ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë për vitin 2018, për aktivitetin e auditimit të raporteve financiare dhe raportit të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2017. Deri në mbledhjen e radhës së KMFP-së, presim një përgjigje. Po ashtu, kryetari theksoi se në mbledhjen e radhës së KMFP-së do të trajtohet raporti i auditimit për MKRS-në dhe rekomandimet për MPMS-në.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj